



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:171579

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05583999

KE.nr.98/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Komuna e Mitrovicës së Jugut, me seli në rr. “Bedri Gjinaj” të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M., kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë, me seli në rr. “Zagrebit” nr. 60, Prishtinë, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, me datë 17.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi Komuna e Mitrovicës së Jugut, me datë 23.08.2022 përmes të autorizuarit të tyre ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material nga zbatimi i Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin C.nr.4178/22, të datës 24.05.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe lëndën e ka dërguar për vendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, me arsyetim së në kuptim të dispozitave nga neni 13 par.1 të Ligjit 06/L-015 të Gjykatës Komerciale, kompetente është Gjykata Komerciale në Prishtinë, sipas kompetencës lëndore sepse Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare, ndërmjet personave juridik publik dhe privat në çështjet e ndërsjella tregtare.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: “Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”, vlerëson se në rastin konkret është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se çështjet që kanë të bëjnë me përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkak se nuk hyn në kuadër të çështjeve të ndërsjella tregtare dhe as çështjeve tjera që ndërlidhen me raportet afariste në mes tyre.

Pra, edhe pse në këtë rast kemi të bëjmë me persona juridik publik, nuk kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare, e që sipas dispozitës ligjore të lartcekur, është kusht që palët të jenë persona juridik dhe njëkohësisht kontesti të ketë të bëjë me çështje të ndërsjella tregtare, pra të plotësohen këto dy kushte në mënyrë kumulative, nëse njëra nga këto mungon atëherë nuk kemi të bëjmë me çështje tregtare dhe rrjedhimisht nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës për të gjykuar në këtë çështje juridike.

Andaj Gjykata Komerciale e Kosovës duke vepruar sipas dispozitës së nenit 24 par.1 dhe 25 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.98/24, datë 17.04.2024.

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.